



A.nr.343/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj–Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtare, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.343/2026 të datës 25.03.2026 të parashtruar nga ankuesja V.K, nga Peja, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.06.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.343/2026, e datës 25.03.2026, e parashtruar nga ankuesja V.K.

II. Mbeten në fuqi Njoftimi i datës 12.03.2026, të Komisionit të Pranimit, të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për rezultatet përfundimtare nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, për pozitën e punës “*Zyrtar Ligjor*” në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, Gjykatën e Apelit-Prishtinë, Gjykatën Themelore në Prishtinë, Gjykatën Themelore në Pejë, dhe Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të shpallur sipas Konkursit të Jashtëm Nr.03/2025, të datës 12.11.2025.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, V.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 25.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa me datë 18.05.2026 ka bërë plotësimin e ankesës, kundër Rezultateve përfundimtare si dhe ligjshmërisë së procedurës së rekrutimit, i cili është përcjell me pa rregulluesi sipas ankueses.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 31.05.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 15.04.2026, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1487/2026 të parashtruar nga ankuesja me datë 25.03.2026 në Këshill; Plotësimin e ankesës të datës 24.04.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.03.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 20.04.2026; Kopjen e Konkursit, për pozitën e punës “ Zyrtares/Ligjore ”; Listën e ngushtë të kandidatëve të cilët kanë aplikuar në këtë procedurë rekrutimi; Rezultatet përfundimtare nga testi me shkrim dhe intervista me gojë; Vendimin për themelimin e Komisionit të vlerësimit së bashku me Akt Emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimi; Testet me shkrim për kandidatet fitues dhe ankueses; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë nga anëtarët e Komisionit; Njoftimin për rezultatin përfundimtar; Dosjen e kandidatit/palës ankuese në Këshill, sipas së cilës dëshmohet përvoja profesionale si dhe aftësitë tjera; Dosjet e kandidatëve të përzgjedhur sipas njoftimit përfundimtar.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është ***e pabazuar, sepse:***

Nga analizimi i provave të lëndës, rrjedhë se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 12.11.2025, ka shpallur Konkursin e Jashtëm Nr.03/2025, për nëntëdhjetë e katër (94) pozita pune, ndërsa katër dhjetë e një (41) për pozitën e punës “Zyrtar Ligjor”, duke përfshirë dy (2) pozita në Sekretariatit e KGJK-së, një (1) pozitë në Gjykatën Supreme të Kosovës, dy (2) pozita në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, **dy (2) pozita, një (1)- komunitetin serb dhe një (1) komunitetin më pak i përfaqësuar në Gjykatën e Apelit**, katër (4) pozita 1- komunitetin serb në Gjykatën Komerciale, tetëmbëdhjetë (18) pozita, dy (2) prej tyre për komunitetin serb dhe një (1) komunitetin më pak i përfaqësuar, në Gjykatën Themelore në Prishtinë; dy (2) pozita në Gjykatën Themelore në Prishtinë- dega Lipjan; dy (2) pozita në Gjykatën Themelore në Prishtinë- dega Graçanicë; dy (2) pozita në Gjykatën Themelore në Gjilan; dy (2) pozita një (1) komunitetin më pak i përfaqësuar, në Gjykatën Themelore në Pejë; një (1) pozitë në Gjykatën Themelore në Gjakovë -dega Rahovec; një (1) pozitë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë; një (1) pozitë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë- dega Skenderaj; një (1) pozitë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë- dega Vushtrri, me afat aplikimi nga data 12.11.2025 deri më datë 11.12.2025.

Tutje, bazuar në Kërkesën për Punësim të datës 18.11.2025, rezulton se ankuesja ka aplikuar për pozitën *Zyrtar Ligjor* në: Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, Gjykatën e Apelit, Gjykatën Komerciale dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe se e njëjta ka marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit duke arritur gjithsejtë 76.94 pikë, gjegjësisht 57.1 pikë nga testi me shkrim dhe 19.8 pikë nga intervista me gojë, ashtu që sipas Rezultateve përfundimtare të vlerësimit nga testi me shkrim dhe intervista me gojë të datës 12.03.2026, të Komisionit të Pranimi të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, rezulton se e njëjta nuk ka arritur pikët e mjaftueshme për tu shpallur kandidate fituese për pozitën e punës *Zyrtar Ligjor*, gjegjësisht në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, është renditur e katërmëdhjeta (14), në Gjykatën Themelore në Prishtinë është renditur e njëzet e gjashta (26), në Gjykatën Themelore në Pejë, është e renditur e gjashta (6), në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është e renditur e gjashta (6), ndërsa në Gjykatën e Apelit kanë qenë dy pozita të cilat kanë qenë të rezervuara për komunitete.

Rrjedhimisht, sipas Rezultateve përfundimtare të datës 12.03.2026, nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, të Komisionit të Pranimit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, rezulton se kandidatet fitues për pozitën e punës *Zyrtar Ligjor* në ***Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme*** janë: G.K me gjithsejtë 83.68 pikë dhe Z.I me gjithsejtë 79.9 pikë. Ndërsa, në ***Gjykatën Themelore në Prishtinë*** për pozitën e punës *Zyrtar Ligjor*; janë gjithsejtë pesëmbëdhjetë (15) kandidatë fitues: D.K me gjithsejtë 87 pikë; Z.K me gjithsejtë 85,8 pikë; T.H me gjithsejtë 81,7 pikë; E.A me gjithsejtë 80,64 pikë, E.H me gjithsejtë 80,6 pikë; E.B me gjithsejtë 80,2 pikë; B.G me gjithsejtë 79,86 pikë; L.RR me gjithsejtë 79,86 pikë; A.R me gjithsejtë 79,1 pikë; F.A 78,9 gjithsejtë; L.M.SH me gjithsejtë 78,2 pikë; A.Ç me gjithsejtë 78,1 pikë; J.R.I me gjithsejtë 77,54 pikë; M.G me gjithsejtë 77 pikë; T.J a me gjithsejtë 76,98 pikë, në ***Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës*** për pozitën punës *Zyrtar Ligjor*, rezulton gjithsej një (1) kandidatë fitues: J.P gjithsejtë me 78,3 pikë; Si dhe në ***Gjykatën Themelore në Pejë*** për pozitën e punës *Zyrtar Ligjor*, rezultojnë dy (2) kandidatë fituese: B.SH me gjithsejtë 82,7 pikë, si dhe një (1) kandidate në radhë të komunitetit me më pak të përfaqësuar si fituese: A.M me gjithsejtë me 72,76 pikë.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se procedura e rekrutimit për pozitën *Zyrtar Ligjor* sipas konkursit të jashtëm Nr.03/2025 të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është përcjell me shkelje të dispozitave kushtetuese, ligjore dhe nënligjore e njëjta kërkon që të anulohen rezultatet përfundimtare të publikuara me datë 12.03.2026 duke përfshirë verifikimin e ligjshmërisë së listave të kandidateve, mënyrën e testimit dhe vlerësimin të intervistës me gojë, po ashtu ankuesja kërkon sigurimin e provave të incizimeve të kamerave të sigurisë në Kolegjin AAB për ditën e mbajtjes së testit me shkrim.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit në pikëpamje të kompetencës lëndore të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje administrative, ju referua nenit 6, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, i cili përcakton se: “4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë”, kështu që, nisur nga ky referim ligjor rrjedhë së të punësuarit në administratë të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor kanë statusin e nëpunësit civilë më status të veçantë dhe së mbi këtë bazë ligjore Këshilli Gjyqësor me akt të veçantë ligjor ka rregulluar procedurën e pranimit të nëpunësve civilë në këtë institucion gjegjësisht me Rregulloren Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuase për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Kolegji i Këshilli, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e pranimit për pozitën *Zyrtar Ligjor* dhe si rrjedhojë Kolegji ka gjetur se si kërkesa të përgjithshme për këtë pozitë të punës janë përcaktuar: **-Arsimi i kërkuar: Diploma universitare të vlefshme në Kosovë: Fakulteti Juridik; -Përvoja e punës e kërkuar: Së një (1) vit përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.** Andaj Kolegji i Këshillit konstaton se shpallja e konkursit për pozitën përkatëse është në pajtim

me nenin 26 të Rregullores Nr.02/2024 për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, ku përcaktohet përshkrimi i përgjithshëm i punës, klasat, emërtesat për Kategorinë Profesionale 1, në të cilën hynë edhe pozita Zyrtar Ligjor e renditur tek nën paragrafi 6.16, detyrat dhe përgjegjësit, karakteristikat sipas faktorëve të klasifikimit, kërkesat (njohuritë, aftësitë dhe cilësitë) e përgjithshme të nevojshme si dhe kërkesat e përgjithshme formale.

Ndërlidhur si me lartë, Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses mori parasysh dispozitat e Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, me theks të veçantë :

- Nenin 3, Parimet për pranimit: *Pranimi në detyrë i të punësuarve në administratën e sistemit gjyqësor bazohet në procedurë të hapur dhe konkurruese duke siguruar profesionalizëm, integritet, mos-diskriminimin, transparencës, pavarësinë, paanshmërinë, meritokracinë, si dhe të pasqyroj natyrën shumë etnike dhe parimet e barazisë gjinore siç janë të garantuara në Kushtetutën e Republikës, marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe në ligjet e aplikueshme të Republikën e Kosovës.*
- Nenin 7, Komisioni i Pranimit: *1. Vlerësimi profesional i kandidatëve për emërim në një pozitë të kategorisë profesionale behët nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit për kategoritë profesionale ka pesë (5) anëtarë të rregullt dhe për secilën kategori të anëtareve të komisionit caktohet një anëtarë zëvendësues, në këtë përbërje: 2.1 tre (3) nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues apo të ulet drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilën zhvillohet konkurrimi ku njëri nga ta caktohet Kryetar i Komisionit; 2.2. një (1) përqafueses nga NJMBNJ; dhe 2.3 një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse për të cilën zhvillohet konkurrimi.*
- Nenin 17, Vlerësimi profesional i kandidatëve: *1. Vlerësimi profesional i kandidatëve, zhvillohet nga komisioni i pranimit dhe përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 2. Vlerësimi profesional i kandidatëve zhvillohet në dy faza : 2.1. Faza e parë: vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim; dhe 2.2. Faza e dytë: vlerësimi nëpërmjet intervistës me gojë.....,*
- Nenin 19, Testi me shkrim: *1. Testi me shkrim, përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje me përgjigje të shumëfishtë me një përgjigje të saktë prej të cilave: dhjetë (10) pyetje nga njohuritë e përgjithshme institucionale dhe pesëmbëdhjetë (15) pyetje me njohuri që lidhen me vendin e punës dhe katër (4) ese të shkurtër, me maksimum njëqind (100) fjalë, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara për pozitën e shpallur. 2. Secila përgjigje e saktë e pyetjeve me përgjigje të shumëfishtë nga testi me shkrim sipas paragrafit 1 të këtij neni, vlerësohet me një pikë gjatë (1.6) pikë dhe në këtë pjesë kandidati mund të fitojë dyzet (40) pikë, ndërsa eset mund të vlerësohet me tridhjetë (30) pikë apo secila ese më se shumti me nga shtatë pikë pesë (7.5) pikë. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.....*
- Nenin 20 Vlerësimi i testit me shkrim, ku përcaktohet se: *1. Vlerësimin e testit me shkrim e bënë komisioni i pranimit dhe atë më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e mbajtjes së provimit, përveç rasteve kur kemi numër të madh të testeve për të vlerësuar dhe kjo duhet arsyetuar me shkrim nga kryetari i komisionit. 2. Komisioni në ditën kur fillon vlerësimi hap pakon ku gjenden plikot e formatit A-4 dhe vlerëson testin me shkrim në bazë të kodit të shënuar në plikon A-4 në të cilën ndodhet testit pa ditur të dhënat e kandidatit. 3. Komisioni do të diskualifikojë secilin test i cili mund të ketë një shenjë identifikuese të bërë me qëllim. 4. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë, për të gjitha kategoritë, vlerësohen duke u bazuar në saktësinë e përgjigjes dhe duke fituar numrin e pikëve për secilën pyetje*

ashtu siç është përcaktuar në nenin 19 paragrafi 2, varësisht nga kategoria e pozitës për të cilën është mbajtur testi. 5.Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e komisionit të pranimit në mënyrë individuale dhe mbledhja e pikëve të secilit anëtar të komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e komisionit. 6.Vlerësimi minimal apo maksimal i esesë duhet të arsyetohet me shkrim nga vlerësuesi. 7.Shuma e pikëve të vlerësuara nga paragrafi 4 dhe 5 përbën vlerësim përfundimtar të testimit me shkrim për një kandidat.... 8.Formularët e vlerësimit të cilët janë të identifikuar si kod plotësohen dhe nënshkruhen nga komisioni i pranimit dhe bashkohen me plikot e formatit A-4 që përmban të njëjtin kod.

- Nenin 22 Vlerësimi i kandidatëve përmes intervistës me gojë, ku përcaktohet se: 1. Pas vlerësimit të testi me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me intervistën me gojë e cila duhet të përfundojë më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar testimin me shkrim. 3.Intervista zhvillohet nga komisioni i pranimit i cili përgatit apo përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon SMDEAGj (kur e njëjta të jetë funksionale), dhe pyetjet duhet të jenë të njëjta për të gjithë kandidatët të cilët intervistohen brenda një dite. 4.Përveç pyetjeve, anëtarët e komisionit të pranimit mund të parashtrojnë nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 5.Intervista për të punësuarit në kategorinë profesionale dhe kategorisë staf teknik dhe mbështetës përmban pesë (5) pyetje, kryesisht rreth pozitës për të cilën intervistohet, ku secila vlerësohet me më së shumti pesë (5) pikë.....7.Secili nga anëtarët e komisionit të pranimit bënë vlerësimin e detajuar për secilën pyetje dhe për secilin rast të vlerësimit minimal apo maksimal duhet të jep arsyetim me shkrim. 8.Në intervistë kandidati mund të marrë më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre (5) janë për jetëshkrimin (CV). 9.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 9.1.deris në dy pikë (2.5) pikë për përvojën relevante në punë më të gjatë se sa ajo që është kërkuar me konkurs; dhe 9.2.deris në dy pikë (2.5) pikë për trajnimet relevante në fushën përkatëse. 10.Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të të gjithë anëtarëve të komisionit të pranimit....

- Nenin 23, Shpallja e rezultatit përfundimtar, ku përcaktohet se: 1.Vlerësimi përfundimtar i kandidatit përfshinë shumën e pikëve të fituara në testin me shkrim dhe intervistën me gojë. 2.Në përfundim të vlerësimit, komisioni i pranimit përgatit listën përfundimtare të kandidatëve emrin dhe mbiemrin, numrin total të pikëve të fituara e cila është shuma e pikëve të fituara gjatë intervistës me shkrim dhe me gojë dhe kandidati fitues konsiderohet kandidati i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pakë se shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale të vlerësimit. 2. të gjithë kandidatët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. 2.2.lista e kandidatëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNJ, si dhe në faqen zyrtare të Këshillit.

Andaj, referuar kuadrit ligjor si me lartë, Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës ka konstatuar së përbërja e Komisionit të Pranimit, i themeluar sipas Vendimit me numër protokollit 03/363, të datës 12.02.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 7 të Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Tutje, lidhur me fazën e vlerësimit të testit me shkrim të kandidatëve, Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se testi më shkrim është hartuar në formatin e kërkuar sipas nenit 19 të Rregullores Nr.01/2024, gjegjësisht pjesa e parë lidhur me njohuritë e përgjithshme institucionale, ka përfshirë 10 pyetje më zgjidhje të shumëfishtë, pjesa e dytë e testit përkitazi më njohuritë lidhur me vendin e punës ka përmbajt gjithsej 15 pyetje me zgjidhje të shumëfishtë, dhe pjesa tretë e testit që ka të bëjë me ese ka përmbajt 4 ese të shkurtra. Ndërsa, Kolegji i Këshillit nga analizimi i testit me shkrim të ankueses ka konstatuar së në pjesën e parë, ankuesja ka dhënë tetë (8) përgjigje të sakta duke grumbulluar 12.8 pikë, në pjesën e dytë ka grumbulluar 20.8 pikë, kurse në pjesën e esëve është vlerësuar me gjithsej 23.5 pikë, duke arritur kështu gjithsejtë 50.1 pikë nga vlerësimi i testit me shkrim, si rrjedhojë në kuptim të paragrafit 4 të nenit 19 të kësaj rregulloreje, e njëjta ka kaluar pragun e kalueshmërisë së testit me shkrim dhe ka fituar të drejtën për pjesëmarrje në intervistën me gojë, dhe se nga shqyrtimi i shkresave rezulton se ankuesja është vlerësuar nga anëtarët e Komisionit të Pranimit me gjithsejtë 19.8 pikë nga 30 pikë maksimale, respektivisht, lidhur me përgjigjet në pyetjet e parashtruara është vlerësuar me 19.8 pikë, tek fusha e përvojës së punës është vlerësuar me 2.5 pikë maksimale, ndërsa tek fusha e trajnimeve është vlerësuar me 0 pikë. Kështu që nisur nga kjo gjendje faktike, Kolegji i Këshillit bazuar ne provat e parashtruara nga ankuesja dhe organi i punësimit nuk ka rritur të argumentoj pretendimet e ankueses si të bazuara.

Kolegji i Këshillit, në kontekst të vlerësimit të procedurës përkatëse të rekrutimit ka shqyrtuar dhe analizuar dosjet e të gjithë kandidatëve fitues, dhe atë duke filluar nga kandidatet fituese në **Dhomën e Posaçme** dhe ka konstatuar se kandidatja **G.K** posedon Diplomën me numër 249 dhe mori titullin Baçellor në Juridik, Përvojën e punës-praktikë gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prizren nga data 01.04.2022 deri më datë 31.03.2023 sipas vërtetimit të datë 31.03.2023 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren po ashtu, edhe kandidatja fituese **Z.I** posedon Diplomën me numër 3593 dhe mori titullin Jurist i Diplomuar-Baçellor në Juridik, Përvojën e punës -*Zyrtare ligjore* në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme nga data 01.06.2023 dhe vazhdon, lëshuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, dhe rrjedhimisht kanë plotësuar kriteret formale të konkursit sa i përket shkollimit dhe përvojës së punës.

Kolegji i Këshillit me qëllim të konstatimit të ligjshmërisë së procesit, ka shqyrtuar edhe dosjet e kandidatëve që janë shpallur fitues në **Gjykatën Themelore në Prishtinë** dhe atë si vijon: kandidatja **D.K** posedon diplomën nr.8362 me të cilën dëshmohet se ka diplomuar në fakultetin juridik me datë 02.12.2022 si dhe posedon Certifikatën e datës 23.10.2024 sipas së cilës konstatohet se e njëjta ka kryer Praktikën Gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë nga data 23.10.2023 deri më datë 24.10.2024 dhe rrjedhimisht ka plotësuar kriteret formale të konkursit sa i përket shkollimit dhe përvojës së punës; Kandidatja **Z,K** posedon diplomën nr. 810/45-64 me të cilën dëshmohet se ka diplomuar me datë 10.09.2024 në fakultetin juridik, posedon Certifikatën e datës 27.10.2025 me të cilën dëshmohet se ka kryer Praktikën Gjyqësore (vullnetare) nga data 28.10.2024 deri me datë 27.10.2025 dhe rrjedhimisht ka plotësuar kriteret formale të konkursit; Kandidatja **T.H** posedon diplomën me nr.8532 me të cilën dëshmohet se e njëjta ka diplomuar në fakultetin juridik me datë 29.06.2023, si dhe posedon Certifikatën e datës 11.03.2025 me të cilën konstatohet se kandidatja ka përfundua Praktikën Gjyqësore në Gjykatën Themelore nga data 12.03.2024 deri më datë 11.03.2025, kandidatja posedon edhe përvojë tjetër të bashkëngjitur në aplikacion, me çka dëshmohet se e njëjta ka plotësuar kushtet formale të konkursit; kandidatja **E.H** posedon diplomën nr.4885 me të cilën dëshmohet se e njëjta ka diplomuar në fakultetin juridik më datë 14.09.2017, si dhe posedon Vërtetimin nga USAID Programi për Fuqizimin e Sektorit të

Drejtesisë në Kosovë me të cilën dëshmon se ka punuar Zyrtare Ligjore nga marsi 2019 deri me 30 shtator 2019 si dhe Vërtetimin e datës 02.08.2021 me të cilin dëshmohet se ka qenë në marrëdhënie pune nga data 12.10.2020 deri me date 06.08.2021 e lëshuar nga Drejtoresha Menaxhuese “LM Consulting” SH.P.K. ; Kandidatja **E.A** , posedon diplomën nr. 8993 me të cilën dëshmohet se ka diplomuar në fakultetin juridik me datë 28.06.2024, si dhe posedon Certifikatën me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Praktikën Gjqësore (vullnetare) në Gjykatën Themelore të Prishtinës nga data 28.10.2024 deri më datë 27.10.2025 dhe rrjedhimisht kandidatja ka plotësuar kushtet formale të konkursit; Kandidatja **E.B** , posedon diplomën nr.520 me të cilën dëshmohet se ka diplomuar në fakultetin juridik me datë 12.10.2018, si dhe posedon Certifikatën e datës 28.02.2020 me të cilën dëshmohet se e njëjta ka kryer Praktikën Gjqësore në Gjykatën Themelore në Prizren nga data 01.03.2019 deri më datë 28.02.2020, kandidatja posedon edhe përvojë tjetër të bashkëngjitur në aplikacion, me çka dëshmohet se ka plotësuar kushtet formale të konkursit; Kandidatja, **L.RR** , posedon diplomën me nr.8951 me të cilën dëshmohet se ka diplomuar në fakultetin juridik më datë 02.07.2024, si dhe posedon Certifikatën e datës 27.10.2025 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Praktikën Gjqësore (vullnetare) në Gjykatën Themelore në Prishtinë nga data 28.10.2024 deri më datë 27.10.2025 dhe e njëjta ka plotësuar kushtet formale të konkursit; Kandidatja, **B.G**, posedon diplomën nr.7705 me të cilën dëshmohet se e njëjta ka diplomuar në fakultetin juridik me datë 27.09.2021, si dhe certifikatën e datës 21.10.2024 me të cilën dëshmohet se ka kryer Praktikën Gjqësore (vullnetare) në Gjykatën Themelore në Prishtinë nga data 24.10.2023 deri më datë 23.10.2024 si rrjedhojë e njëjta ka plotësuar kriteret formale të konkursit; Kandidatja, **A.R**, posedon diplomën nr.9075 me të cilën dëshmohet se ka diplomuar në fakultetin juridik me datë 02.07.2024, si dhe posedon Certifikatën e datë 27.10.2025 me të cilën dëshmohet se ka kryer Praktikën Gjqësore në Gjykatën Themelore të Prishtinës nga data 28.10.2024 deri më datë 27.10.2025 dhe si rrjedhojë e njëjta ka plotësuar kriteret formale të konkursit; Kandidatja, **F.A** , posedon diplomën nr.8460 me të cilën dëshmohet se ka diplomuar në fakultetin juridik më datë 27.06.2023, si dhe Certifikatën e datë 23.10.2024 me të cilën dëshmohet se ka kryer Praktikën Gjqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë nga data 24.10.2023 deri më datë 23.10.2024 dhe si rrjedhojë e shkresave të lëndës ka plotësuar kriteret formale të konkursit; Kandidatja, **A.Ç**, posedon diplomën nr.997 me të cilën dëshmohet se ka diplomuar në fakultetin juridik më datë 01.11.2023, si dhe posedon Certifikatën e datës 01.03.2025 me të cilën dëshmohet se ka kryer Praktikën Gjqësore në Gjykatën Themelore Prizren, nga data 01.11.2024 deri më datë 28.02.2025 dhe si rrjedhojë e njëjta ka plotësuar kriteret formale të konkursit; Kandidatja, **M.G**, posedon diplomën nr.8037 me të cilën dëshmohet se ka diplomuar në fakultetin juridik më datë 01.04.2022, si dhe posedon Marrëveshjen për Fillimin e Punës tek Noter S.B duke filluar nga data 10.10.2024 deri më 31.12.2025 në cilën e Bashkëpunëtores, së cilës marrëveshja ia ka bashkëngjitur edhe pasqyrën e Trustit Pensionale dhe si rrjedhojë e njëjta ka plotësuar kriteret formale të konkursit; Kandidatja **J.R-I**, sipas aktit noterial të lëshuar nga notere Sh.H. me numër 1362/2025 që dëshmon se posedon diplomën me nr.1546/2023 të datës 02.07.2023, si dhe posedon Konfirmimin e datës 24.11.2025 me të cilin dëshmohet se ka kryer praktiken në zyrën e avokatit M.LL. nga data 16.12.2023 deri me datë 15.12.2024, si rrjedhojë e njëjta ka plotësuar kriteret formale të konkursit; Kandidatja, **T.J**, posedon diplomën me nr.8986 me të cilën dëshmohet se ka diplomuar në fakultetin juridik më datë 28.06.2024, si dhe posedon Certifikatën e datë 30.10.2025 me të cilën dëshmohet se ka kryer Praktikën Gjqësore në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës nga data 25.10.2024 deri më datë 24.10.2025, si rrjedhojë e njëjta ka plotësuar kriteret formale të konkursit; Kandidatja, **L.M-Sh** , posedon diplomën me nr.2861 me të cilën dëshmohet se ka diplomuar në fakultetin juridik më datë 23.11.2022, si dhe posedon Vërtetimin e datës 09.12.2019 me të cilën dëshmohet se ka

kryer praktikën në zyrën e avokatit N.S. nga data 09.12.2018 deri më datë 08.12.2029, si rrjedhojë e njëjta ka plotësuar kriteret formale të konkursit.

Kolegji i Këshillit, në kontekst të vlerësimit të procedurës ka shqyrtuar dhe analizuar dosjen e kandidatit fitues, në **Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës** dhe ka konstatuar se kandidati fituese **J.P.** posedon diplomën me nr.8406 me të cilën dëshmon se me date 28.04.2023 ka përfunduar studimet themelore ne Universitetin e Prihtines “Hasan Prishtina” në fakultetin juridik me te cilën mori titullin Jurist i diplomuar, si dhe Vërtetimin e datës 05.11.2025 i cili është i punësuar në zyrën e avokatit S.B. që nga data 01.06.2018 e tutje, në pozitën “*Asistent Ligjor*”, të cilën përvojë e mbështet, dhe me pasqyrën e Trustit Pensionale dhe si rrjedhojë i njëjti ka plotësuar kriteret formale të konkursit.

Kolegji i Këshillit me qëllim të konstatimit të ligjshmërisë së procesit, ka shqyrtuar edhe dosjen e kandidates që është shpallur fituese në **Gjykatën Themelore në Pejë** dhe atë si vijon: Kandidatja, B.SH, posedon diplomën me nr.9006 me të cilën dëshmon se ka përfunduar studimet ne Universitetin e Prishtinës, në fakultetin juridik më datë 02.07.2024 dhe mori titullin Jurist i diplomuar; Certifikatë e datës 07.10.2025 me numër protokollit 355/2025 me të cilën dëshmohet se ka kryer Praktikën Gjyqësore në Gjykatën Themelore në Pejë nga data 07.10.2024 deri më 06.10.2025, dhe si rrjedhojë e njëjta ka plotësuar kriteret formale të konkursit.

Ndërsa, lidhur me pretendimin për procedurën e rekrutimit për plotësimin e dy pozitave të lira Zyrtar Ligjor pranë **Gjykatës së Apelit**, bazuar në konkursin me numër 03/2025 te datës 12.11.2025, Kolegji i Këshillit, Gjykata e Apelit ka hapur dy (2) pozitat përkatëse, mirëpo një (1) pozitë të rezervuar për komunitetin serb, ndërsa, tjetrën pozitë të rezervuar për komunitet më pak të përfaqësuar, dhe duke qenë se ankuesja me rastin e dorëzimit të dokumentacionit të saj me datë 18.11.2025, në faqen e parë të kërkesës për punësim tek fusha e përfaqësimit etnik ka vendosur deklarinimin “Shqiptare”, Kolegji i Këshillit, vlerëson se të njëjtës me këtë rast nuk i është cenuar asnjë e drejtë, për faktin se për këto dy pozita pranë kësaj gjykate, të gjithë kandidatët pjesëmarrës kanë qenë të njoftuar se janë të rezervuara për komunitetet jo Shqiptare, nga rrjedhë se pavarësisht vlerësimit të përgjithshëm, nëse kandidati nuk ka ofruar dëshmi se i përket këtyre komuniteteve, i njëjti nuk do të plotësonte kriteret për praninë në këtë pozitë punë të administratës së sistemit gjyqësor.

Po ashtu ankuesja në plotësimin e ankesës së datës 24.04.2026, pretendim ka edhe Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, lidhur me parregullsitë e testit me shkrim për pozitën *Zyrtar Ligjor*, mirëpo këshilli duke u bazuar në aplikacionin e datës 14.11.2025 të ankueses, si dhe përgjigjen e organit të punësimit, nuk figuron se ankuesja ka aplikuar në këtë gjykatë andaj pretendimet lidhur me procedurën e rekrutimit për këtë gjykatë hedhen poshtë si të pa lejuar, pasi që e njëjta nuk ka qenë pjesë e kësaj procedure dhe nuk i është cenuar asnjë e drejtë.

Andaj, duke qenë se kandidatët e sapo theksuar plotësojnë kërkesat e përgjithshme formale dhe se në fund të procedurës se vlerësimit kanë rezultuar si kandidatët me më shumë pikë të arritura të vlerësimit, atëherë edhe Komisioni i Pranimi të njëjtit me të drejtë i ka shpallur kandidatë fitues për pozitat *Zyrtar Ligjor*, sikurse parashihet më nenin 23 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimi, Emërimit dhe Punës Provuere për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, dhe meqenëse nuk është evidentuar ndonjë shkelje esenciale e karakterit procedural apo material dhe duke qenë së pretendimet ankimore nuk janë vërtetuar si të bazuara, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundim së procedura e pranimit sipas Konkursit të Jashtëm Nr.03/2025 të datës 12.11.2025, për pozitën e punës “Zyrtar Ligjor” në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, Gjykatën e Apelit, Gjykatën Themelore në Prishtinë, Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Gjykatën Themelore në Pejë është zhvilluar në pajtim me nenin 39 të Ligjit Nr.

08/L-197 për Zyrtarët Publikë si dhe dispozitat e Rregullores Nr. 01/2024 për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Ndërsa, lidhur me kërkesën për qasje në kamerat dhe provat e incizuara gjate ditës se mbajtjes se testit me shkrim ka zotëruar te drejtën që të kërkojë nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Kështu që, thënë si me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS **Lënda, A.nr.343/2026**

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankueses, V.K;*
- *Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; si dhe,*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*